



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## BASHKIA KORÇË

### RELACION

#### **PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR 168 DATË 24.11.2022 PËR “NIVELIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE, ADMINISTRIMIN E TYRE NË BASHKINË E KORÇËS SI DHE PENALITETET PËR SHKELJET APO KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE PËR VITIN 2023”**

Mbështetur në Ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, ligjin nr. 64, dt. 31.05. 2012, “Për peshkimin”, i ndryshuar, urdhërin e përbashkët nr.443, datë 6.10.2022 i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për përcaktimin e tarifave të autorizimit për peshkimin çlodhës-argëtues dhe tarifave për shërbimet që ofrohen nga organizatat e peshkimit”, udhëzimin nr. 6, datë 11.4.2022 “Për mjetet që përdoren për peshkimin çlodhës-argëtues dhe mënyrën e lëshimit të autorizimit” propozojmë të bëhet një ndryshim në Vendimin e Këshillit të Bashkisë Korçë nr. 168 datë 24.11.2022 “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë e Korçës si dhe penalitetet për shkeljet apo kundravajtjet administrative për vitin 2023” si më poshtë:

- Propozim për shtimin e kategorisë për Tarifat e autorizimit të peshkimit çlodhës-argëtues dhe miratimin e tarifës për peshkimin amator në ujërat e brendshme .

I gjithë aktiviteti i peshkimit në Republikën e Shqipërisë zhvillohet në bazë të ligjit nr. 64, dt. 31.05. 2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar. Për vetë kushtet që ka territori i Bashkisë Korçë, peshkimi amator nuk ka ndonjë zhvillim të dukshëm. Ky lloj aktiviteti kryhet në ujërat e Lumit Dunavec si dhe në ujëmbledhësat e bujqësisë ku rezervuari i Gjançit është më i madhi. Lumenjtë malorë ku mund të ushtrohet ky aktivitet janë lumi Çëmericë-Denas, rrjedhat e sipërme të Lumit Osum në Shtyllë-Vithkuq-Leshnjë-Lubonjë dhe disa përenj të vegjël lokale si: proi i Kamenicës, Dërsnikut, Drenovës, Voskopit, Voskopojës. Nga informacionet që kemi mbledhur na rezulton se peshkatarët amatorë që janë banorë të Bashkisë sonë nuk janë të organizuar në shoqata, por aktivitetin e kryejnë në mënyrë spontane. Paisja e tyre me autorizim do të bëjë që ata të jenë të organizuar, të mbrojtur në aktivitetin e tyre si dhe duke respektuar të gjithë rregullat që përcakton ligji.

Në ligjin 64/2012, neni 5, pika 64, neni 39, pika a, neni 40, pika 5, neni 43, pika 2, janë të përcaktuara qartë të gjitha rregullat për ushtrimin e këtij aktiviteti.

Në nenin 40, pika 5 thuhet “..autorizimi për peshkimin amator lëshohet nga autoriteti përgjegjës i vetëqeverisjes vendore..” Në bazë të ligjit 64/2012, ka dalë udhëzimi nr. 6, datë 11.4.2022 “Për mjetet që përdoren për peshkimin çlodhës-argëtues dhe mënyrën e lëshimit të autorizimit” ku në kreun VI pika 4 thuhet: “..Autorizimi lëshohet nga organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet portalit e-Albania..”Një nga dokumentët që duhet të ngarkohen në sistem, është dhe

pagesa e tarifës për paisjen me autorizim. Masa e kësaj tarife është e përcaktuar në urdhërin e përbashkët nr.443, datë 6.10.2022 i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për përcaktimin e tarifave të autorizimit për peshkimin çlodhës-argëtues dhe tarifave për shërbimet që ofrohen nga organizatat e peshkimit” ku shprehet se: “Tarifa e autorizimit për peshkim amator në ujrat e brendëshme ..” të jetë 1,000 ( një mijë) lekë për 1 (një) vit.

Bazuar në informacionet që disponojmë por dhe në bashkëbisedimet me një pjesë të peshkatarëve amatorë, parashikojmë që për vitin 2023 të paraqiten pranë Bashkisë për tu paisur me këtë lloj autorizimi rreth 10-15 persona

Për sa më sipër propozojmë për miratim:

- Tarifë për peshkimin amator në ujërat e brendshme **1,000 lekë / vit**

**Efekti financiar që do të shoqërojë nga miratimi i kësaj tarifë përllëgaritet në masën 15,000 lekë në vit dhe do të përllëgaritet dhe arkëtohet nga Sektori i Bujqësisë në Bashkinë Korçë**

**Drejtoresha e Drejtorisë së Përgjithshme  
Juridike dhe të Menaxhimit  
të Burimeve Njerëzore**

**Drejtoresha e Taksave dhe Tarifave Vendore**

**Anxhela Qeramixhi (Dishnica)**

**Soniel Prifti**

**Sektori i Bujqësisë**

**Drejtoresha e Përgjithshme e Financës, Buxhetit**

**dhe M.F.K**

**Thanas Koroveshi**

**Valbona Ziko**

**KRYETARI I BASHKISË**

**Sotiraq FILO**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË  
KËSHILLI BASHKIAK**

**P/V E N D I M**

Nr. \_\_\_\_\_ datë \_\_\_\_\_ 2023

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR 168 DATË 24.11.2022 PËR  
“NIVELIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE, ADMINISTRIMIN E TYRE NË  
BASHKINË E KORÇËS SI DHE PENALITETET PËR SHKELJET APO  
KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE PËR VITIN 2023”**

Këshilli i Bashkisë Korçë, në mbledhjen e tij të datës së sotme pasi mori në analizë relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe nga Sektori i Bujqësisë, mbështetur në Ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, ligjin 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjin nr. 64, dt. 31.05. 2012, “Për peshkimin”, i ndryshuar, udhëzimin nr. 6, datë 11.4.2022 “Për mjetet që përdoren për peshkimin çlodhës-argëtues dhe mënyrën e lëshimit të autorizimit”, urdhërin e përbashkët nr.443, datë 6.10.2022 i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për përcaktimin e tarifave të autorizimit për peshkimin çlodhës-argëtues dhe tarifave për shërbimet që ofrohen nga organizatat e peshkimit”, mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimeve të anëtareve.

**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDOSI**

1. Të miratojë, ndryshimin në vendimin nr 168 datë 24.11.2022 për “NIVELIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE, ADMINISTRIMIN E TYRE NË BASHKINË E KORÇËS SI DHE PENALITETET PËR SHKELJET APO KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE PËR VITIN 2023” si më poshtë:

Në Kapitullin IV, Tarifat Vendore, shtohet **pika 13, Tarifat e autorizimit të peshkimit çlodhës-argëtues:**

- Tarifë për peshkimin amator në ujërat e brendshme **1,000 lekë / vit**

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Bujqësisë në Bashkinë Korçë.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

Sekretari i Këshillit Bashkiak

**Eva NAÇI**

Miratuar me \_\_\_\_\_vota

Vota Pro\_\_\_\_\_

Vota Kundër\_\_\_\_\_

Vota Abstenim\_\_\_\_\_

**K R Y E T A R**

**Erjon NEXHIPI**